

Nr. 2021 / Prot.  
288

Tiranë, më datë 21.09.2022

## DEKLARATË

Të nderuar prindër,

Duke shprehur konsideratën tonë më të lartë dhe duke Ju falenderuar për mbështetjen Tuaj të vazhdueshme, dëshirojmë t'Ju informojmë lidhur me aktin më të fundit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Republikës e Shqipërisë për mbylljen e aktivitetit të kopshtit jopublik "Zübeyde Hanım", Tiranë, pjesë e shoqërisë Turgut Ozal EDUCATION Sh.a.

Institucionet arsimore në varësi të "Turgut Ozal Education" Sh.a. kanë qenë ndër institucionet e para arsimore private të krijuara në Shqipëri pas rënies së regjimit komunist. Gjatë gjithë kësaj periudhe, institucionet tona kanë ofruar një arsim cilësor në të gjitha nivelet në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare duke përfshirë kopshtin, shkollat fillore, shkollat e mesme, si dhe Universitetin "EPOKA" që përfaqëson kurorën e këtij suksesi, ashtu siç është vlerësuar vazhdimisht nga agjenci të ndryshme renditjeje dhe akreditimi si universiteti privat më i mirë në Shqipëri. Që nga themelimi i tyre, këto institucione arsimore kanë kontribuar në rritjen e brezit të ri të pajisur me njohuritë, aftësitë dhe vlerat e nevojshme që do t'u mundësojnë atyre të shkëlqejnë në një botë që ndryshon me shpejtësi.

Kopshti jopublik "Zübeyde Hanım" është institucion i licencuar me Urdhërin e Ministrit përgjegjës për arsimin Nr.67, datë 15.10.1998, me adresë në Rrugën e Kavajës. Ky institucion, me rritjen e kërkesës nga ana e prindërve si dhe për t'i ardhur në ndihmë edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore dhe më tej, ka vazhduar veprimtarinë e tij me standarde më moderne dhe duke përfshirë të gjithë inovacionet teknologjike në mbështetje të procesit mësimor, në kompleksin arsimor parauniversitar jopublik "Turgut Ozal" në ish-qytetin e nxënësve, përkatësisht Rruga "Bernardin Palja", Ndërtesa 15, Hyrja 1, Njësia Bashkiake Nr.6, Tiranë. Që nga viti 2020, kopshti jopublik "Zübeyde Hanım", miratuar me shkresën nr.3274/4, datë 13.07.2020, të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, vazhdon veprimtarinë edhe në godinën e ndodhur në adresën Aut. Tiranë-Durrës, Rruga Pavarësia km1 Kashar, Tiranë.

Gjatë gjithë kësaj periudhe 24 vjeçare, ky institucion ka ushtruar dhe vazhdon të ushtrojë veprimtarinë e tij nën monitorimin e autoriteteve përkatëse në bashkëpunim korrekt me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Zyrën Vendore Arsimore Tiranë duke dorëzuar pranë këtyre institucioneve të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Megjithatë, pavarësisht reputacionit që gëzojnë institucionet tona arsimore në vend dhe më gjerë, me keqardhje të madhe theksojmë se gjatë muajve të fundit, kopshti “ Zübeyde Hanım” Tiranë (në vijim “kopshti”), ka qenë objekt i inspektimeve të shumta të kryera nga organet në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ( MAS), të cilat kulmuan me miratimin e Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.540, datë 15.09.2022 “Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit privat të arsimit parauniversitar “Zübeyde Hanım” Tiranë”. Në raportet e inspektimit është verifikuar se ky kopsht përmbush të gjithë kriteret e ligjshmërisë si dhe është lënë rekomandim marrja e miratimit për ndryshimin e vendndodhjes së kopshtit. Në zbatim të rekomandimeve, kopshti jopublik “Zubeyde Hanım” në mënyrë të përsëritur ka aplikuar për marrjen e miratimit duke filluar **nga data 16.02.2022.**

Me shkresën e saj nr. 4004/5 Prot., datë 13.09.2022, MAS ka refuzuar kërkesën tonë për miratimin e ndryshimit të vendndodhjes.

Të gjitha këto fakte na bëjnë të vemë në pikëpyetje ligjshmërinë e këtyre veprimeve, të cilat mund të kenë ndodhur nën presione të ndryshme të pakuptueshme nga ana jonë.

Kjo trysni që bie ndesh me vlerat demokratike të një vendi anëtar të NATO-s dhe të një vendi që ka nisur negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, vjen në një kohë kur institucionet tona arsimore janë në kulmin e suksesit të tyre.

Shprehim vendosmërinë tonë për të ndjekur deri në fund rrugën ligjore me organet e drejtësisë në vend dhe më gjerë. Gjithashtu, kemi depozituar dokumentacionin përkatës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për anulimin e këtij Urdhri, si dhe kemi njoftuar të gjitha institucionet e interesuara vendase dhe të huaja për këtë akt të miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit.

Bazuar në sa më sipër, dëshirojmë të kërkojmë edhe njëherë mbështetjen Tuaj gjatë këtij procesi të vështirë, por me besimin e plotë se e drejta do të gjejë vendin që i përket.

Sjellim në vëmendjen Tuaj se drejtuesit dhe stafi pedagogjik në të gjitha institucionet “Turgut Ozal” janë të vendosur në angazhimin e tyre për t’i trashëguar brezave të rinj përmes dritës së dijes, një të ardhme ku mbizotëron njerëzimi, paqja dhe dashuria për familjen dhe atdheun.

Me respekt,

**Tuncer TIRYAKI**

**ADMINISTRATOR I PËRGJITHSHËM**

